



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 gusht 2023  
Nr. ref.: MM 2242/23

## **MENDIM MOSPAJTUES**

i gjyqtarit

**RADOMIR LABAN**

në

**rastin nr. KI161/21**

Parashtrues

**Suzana Zogëjani Sekiraqa**

### **Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 310/220 të 28 prillit 2021**

Duke shprehur që në fillim respektin tim ndaj mendimit të shumicës së gjyqtarëve në këtë rast, të cilët me shumicë votash konstatuan se aktgjykimi [Pml. nr. 310/220] i 28 prillit 2021 i Gjykatës Supreme të Kosovës; se aktgjykimi [PAKR. nr. 328/19] i 20 gushtit 2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimi [PKR. nr. 37/2019] i 17 dhjetorit 2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk janë në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Megjithatë, unë si gjyqtar individual kam mendim mospajtuës në lidhje me konkludimin e shumicës dhe nuk pajtohem me mendimin e shumicës.

Si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në aktgjykim dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, unë si gjyqtar pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur në aktgjykim pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe i pranoj të njëjtat si të sakta.

Megjithatë, nuk pajtohem me analizën ligjore dhe qëndrimin e shumicës në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, nuk pajtohem me mendimin e shumicës për të SHPALLUR TË PAVLEFSHËM aktgjykimin [Pml. nr. 310/220] të 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; aktgjykimin [PAKR. nr. 328/19] të 20 gushtit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të 17 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;

Për sa më sipër dhe në pajtim me rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, për të ndjekur dhe shpjeguar më lehtë dhe qartë mendimin tim mospajtues **(I)** do të rikujtoj pretendimet kryesore të parashtrueses së kërkesës **(II)** të kryejë vlerësimin e kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit dhe pranueshmërinë e provave në procedurë; **(III)** të kryejë vlerësimin e kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët; **(IV)** të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtave gjatë marrjes së dëshmisë së [X.X.], i cili në atë kohë ishte i mitur, i njëjti është shqyrtuar vetëm në prani të punonjës social dhe jo psikologut. **(V)** të shprehë mendimin mbi detyrimin për të vendosur masë të përkohshme sipas detyrës zyrtare (ex officio); **(VI)** të paraqesë një përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtrueses së kërkesës.

## **(I) Rikujtojmë pretendimet kryesore të parashtrueses së kërkesës**

1. Së pari, rikujtoj thelbin e rastit, i cili ka të bëjë me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda, kundër parashtrueses së kërkesës nën dyshimin se ka kryer veprën penale „Vrasje e rëndë“ nga neni 179, paragrafi 1, pika 1.3. dhe 1.4, KPRK. Gjykata Themelore, me aktgjykimin e saj [PKR. 37/2019], e shpalli parashtruesen e kërkesës fajtores për kryerjen e veprës penale që i ngarkohej dhe e dënoi me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Më pas, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shpalljen e saj fajtores, duke pretenduar se ka pasur shkelje të dispozitave penale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Prokuroria Themelore gjithashtu parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke kërkuar që parashtruesja e kërkesës të dënohet me dënim më të rëndë. Gjykata e Apelit aprovoi pjesërisht ankesën e parashtrueses së kërkesës, por edhe sipas detyrës zyrtare, duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, në mënyrë që Gjykata e Apelit për veprën penale për të cilën parashtruesja e kërkesës është shpallur fajtores, ligjërisht e cilësoi si vepër penale “vrasje e rëndë” nga neni 179, paragrafi 1, pika 3 e KPRK-së. Gjykata e hodhi poshtë ankesën e Prokurorisë Themelore si dhe ankesat e tjera të parashtrueses së kërkesës si të pabazuara. Më pas, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimeve të shkallës më të ulët. Gjykata Supreme me aktgjykimin [PML. nr. 310/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës.
2. Të gjitha këto gjetje të gjykatave të rregullta, duke përfshirë edhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme, kontestohen nga parashtruesja e kërkesës në Gjykatë, të cilat mund të përmbliidhen në vijim:
  - i) Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shpërfillë provat materiale të paraqitura nga mbrojtja e parashtrueses së kërkesës dhe se në asnjë instancë gjyqësore nuk është pranuar të paraqiten prova që, sipas mendimit të

saj, do të mbështesnin mbrojtjen “*lidhur me dhunën permanente që viktimat ka ushtruar ndaj paraqitëses së kërkesës, për çka është dënuar me burg nga autoritetet gjyqësore të Francës*”, si dhe refuzimi i kërkesës për ekspertizë psikiatrike, e cila sipas saj do të vërtetonte gjendjen e saj mendore në momentin e kryerjes së veprës penale;

- ii) aktgjykimet e të gjitha shkallëve gjyqësore bazohen në prova të papranueshme dhe shton se sipas pretendimeve të saj, gjykatat e rregullta i kanë shpërfillur detyrimet ligjore duke specifikuar se provat janë marrë përmes kanaleve joformale nga qeveritë e vendeve të huaja, siç ndodhi në rastin e sigurimit të provave dhe provave të tjera materiale, raportet e hetimit të vendit të ngjarjes si dhe raportet e ekzaminimit mjeko-ligjor të dorëzuara nga Franca, të cilat janë prova të papranueshme, përveç rasteve kur provat shoqërohen me një deklaratë nga qeveria franceze ose autoritetet për zbatimin e ligjit se provat janë marrë dhe siguruar në pajtim me ligjin e atij vendi.
  - iii) Më tej, parashtruesja e kërkesës pretendon se gjatë marrjes së dëshmisë nga [X.X.], i cili ishte i mitur, i njëjti është marrë në pyetje vetëm në prani të punonjësit social dhe jo të një psikologu; si dhe
  - iv) Krejt në fund, parashtruesja e kërkesës pretendon se paragrafi 4 i nenit 31 të Kushtetutës është shkelur si pasojë e pamundësisë së saj për të marrë në pyetje të tërthortë dëshmitarët dhe ekspertët, dëshmia e të cilëve ndikoi që parashtruesja e kërkesës të shpallej fajtoare.
3. Në thelb, parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ka shkelur dy parime të garantuara nga e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, konkretisht: (i) parimin e barazisë së armëve dhe parimin e procedurës së kontradiktoritetit dhe pranueshmërinë e provave në procedurë; (ii) e drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët si dhe iii) gjatë marrjes së dëshminë së [X.X.], i cili ishte i mitur në atë kohë, i njëjti u mor në pyetje vetëm në prani të punëtorit social dhe jo të një psikologu.
4. Në këtë drejtim, do t'i shqyrtoj pretendimet e mësipërme duke iu referuar praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në bazë të së cilës Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

**(II) Vlerësimi i kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës në lidhje me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit dhe pranueshmërinë e provave në procedurë**

- 5. Lidhur me këtë, rikujtoj edhe një herë pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me administrimin e provave nga gjykatat e rregullta, të cilat ajo i ka paraqitur edhe në kërkesën e saj për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila është dorëzuar në Gjykatën Supreme.
- 6. Para së gjithash, parashtruesja e kërkesës pretendon para Gjykatës se “*nuk i është lejuar prezantimi i provave të prezantuara nga mbrojtja e saj, që kanë të bëjnë me lëndime të shumta trupore [...] të prezantuara nga mbrojtja përmes fotografive të shumta që i janë prezantuar gjykatës por nuk janë vlerësuar fare nga gjykata por janë injoruar sikur ato të mos ekzistonin fare*”. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës shton se

në asnjë instancë gjyqësore nuk është pranuar shqyrtimi i provave, të cilat, sipas saj, do të ishin në favor të mbrojtjes.

7. Parashtruesja e kërkesës në lidhje me këtë pretendim gjithashtu shton se: *“gjykatat e kanë shpërfillë detyrimin ligjor nga neni 290 par 6 i KPP-së, sipas të cilës dispozitë është parashikuar se provat e siguruara përmes rrugëve joformale nga qeveritë e shteteve të huaja, siç ka ndodhur rasti i sigurimit të dëshmitëve dhe provave të tjera materiale, raportet e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe raportet e ekzaminimit mjekoligjor, të dërguara nga Franca, janë prova të papranueshme, nëse atyre provave nuk u është bashkëngjitur Deklarata e qeverisë franceze apo autoriteteve për zbatim të ligjit se ato dëshmi janë siguruar dhe janë marrë në përputhje me ligjin e atij shteti”*.
8. Në shqyrtimin dhe shtjellimin e mëtejshëm të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, fillimisht do të shtjelloj më tej parimet e përgjithshme të përcaktuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës, si dhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së mbi parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit, duke përfshirë parimet e përgjithshme lidhur me pranueshmërinë e provave në procedurë.

***Parimet e përgjithshme të bazuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit, si dhe në lidhje me pranueshmërinë e provave në procedurë***

9. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në radhë të parë thekson se parimi i *“barazisë së armëve”* është element i një koncepti më të gjerë të gjykimit të drejtë (shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues: *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 97).
10. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës është theksuar se parimi i *“barazisë së armëve”*, kërkon *“ekuilibër të drejtë midis palëve”* ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 98; shih edhe rastet e GJEDNJ-së *Yvon kundër Francës*, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33 shih dhe rastet e Gjykatës, KI52/12, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
11. Rikujtoj më tej se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për rastet civile ashtu edhe për ato penale (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 99; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Dombo Beher B.V. kundër Holandës*, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).
12. Për më tepër, theksoj se gjykimi i drejtë përfshin edhe të drejtën e gjykimit në pajtim me *“parimin e kontradiktoritetit”*, parim i cili është i ndërlidhur me parimin e *“barazisë së armëve”*. (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, para 99).
13. Për më tepër, në kuadër të procedurës penale, GJEDNJ nënvizoi se *“[Ë]shtë një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që procedurat penale, përfshirë edhe elementet e procedurave të tilla që kanë të bëjnë me vet procedurën, duhet të jenë në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ekzistojë barazia e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes”* (shih, rastin e GJEDNJ-së *Leas kundër Estonisë*, kërkesa nr. 59577/08, Aktgjykim i 6 marsit 2012, paragrafi 77). Rrjedhimisht, përkitazi me parimin e kontradiktoritetit, GJEDNJ theksoi se, në një procedurë penale, si

prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të kenë mundësinë që të kenë njohuri dhe të bëjnë komente për të gjitha vërejtjet dhe për të gjitha provat e paraqitura nga pala tjetër (shih, rastin *Brandstetter kundër Austrisë*, të cituar më lart, paragrafi 67).

14. Në anën tjetër, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me paraqitjen e provave dhe pranueshmërinë e tyre, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, në parim thekson se *“Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare”* (shih rastet e GJEDNJ-së *Schenk kundër Zvicrës*, paragrafët 45-46 dhe *Heglas kundër Republikës Çeke*, paragrafi 84). Megjithatë, GJEDNJ ka nënvizuar se aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 102; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 42).

### ***Aplikimi i këtyre parimeve në rastin e parashtrueses së kërkesës***

15. Vërej se parashtruesja e kërkesës i ngriti pretendimet e mësipërme pranë gjykatave të rregullta, duke përfshirë kërkesën e saj për mbrojtjen e ligjshmërisë, ku ndër të tjera deklaroi se dy gjykata të shkallës më të ulët *“duke anashkaluar të drejtën e palës mbrojtëse për propozimin e provave që kanë të bëjnë me vërtetimin e fakteve shfaqësuese për të akuzuarën, siç ishte edhe propozimi për ekzaminimin psikiatrik të saj për të vërtetuar gjendjen e saj psikike në momentin e kryerjes së veprës penale, vërtetimin e ekzistimit të afektit të akumuluar si pasojë e keqtrajtimit të vazhdueshëm të saj [...]*
16. Së pari, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës se nuk është pranuar në asnjë shkallë gjyqësore të shqyrtohen provat, të cilat, sipas pretendimeve të saj, do të ishin në favor të saj, në bazë të sa më sipër dhe duke iu referuar procedurave pranë gjykatave të rregullta, veçanërisht për sa i përket paraqitjes së provave nga këto gjykata, Gjykata së pari i referohet aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila vendimin e saj për dënimin e parashtrueses së kërkesës e ka bazuar në një sasi të konsiderueshme të provave personale dhe materiale të propozuara nga palët për procedurat, si leximi i deklaratave të disa dëshmitarëve, të cilët janë marrë nga shteti francez, dëgjimi i dëshmitarëve H.S, E.H, A.S dhe X.X. në shqyrtimin gjyqësor, leximi i procesverbaleve të shumta që janë përpiluar para autoriteteve franceze. (duke pasur parasysh se vepra penale është kryer në shtetin e Francës ku parashtruesja e kërkesës jetonte së bashku me të ndjerin A.S) raporti i autopsisë gjyqësore i përpiluar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, certifikata e vdekjes për të ndjerin (ish-bashkëshortin e parashtrueses së kërkesës) të nxjerra më 29 shtator 2018, të cilat janë të numëruara në mënyrë shteruese në aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
17. Më tej, i referohem edhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit konstatohet se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Themelore i ka vlerësuar provat në pajtim me dispozitat e nenit 362, paragrafi 2 i KPPK-së, ndërsa për provat kontradiktore, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370, paragrafi 7, të KPPK-së, duke theksuar plotësisht se cilat fakte dhe për cilat arsye i konsideron të vërtetuara apo të paprovuara, prandaj Gjykata e Apelit ka gjetur se Gjykata Themelore ka dhënë shpjegime të mjaftueshme të cilat Gjykata e Apelit e konsideron të drejta. Gjykata e Apelit, lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ka theksuar se *“qasjen ndaj fakteve vendimtare e kishte të drejtë dhe të ligjshme, ashtu që asnjë çështje nuk mbeti e paqartë apo e paprovuar dhe përveçse u vërtetuan siç duhet, të njëjtat u arsyetuan plotësisht dhe saktë..*

18. Gjithashtu, i referohem edhe pjesës specifike të vendimit të Gjykatës së Apelit, e cila lidhet me pretendimin e parashtrueses së kërkesës se provat e propozuara nga mbrojtja e parashtrueses së kërkesës nuk janë shqyrtuar dhe në lidhje me këtë pretendim, Gjykata e Apelit. shton se Gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka marrë parasysh provat materiale të propozuara nga avokati mbrojtës i të pandehurës dhe për të siguruar të njëjtat nga shteti i Francës., *“mirëpo nga shkresat e lëndës dhe nga provat e tjera materiale vërtetohet se edhe provat në fjalë, gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh dhe atë sidomos të dhëna përkitazi me të kaluarën e të akuzuarës dhe tani të ndjerit, në kuptim të jetës bashkëshortore, pastaj nga deklarata e dëshmitarëve – fqinjëve të akuzuarës ka vërtetuar edhe sjelljen e të akuzuarës ndaj tani të ndjerit, sjellje këto, pra, që nuk kanë qenë të atij niveli që do të mund të konkludohej se vetëm tani i ndjeri ka pasur sjellje të dhunshme, ngase edhe për të akuzuarën dëshmitarët në fjalë kanë vërtetuar sjellje agresive të akuzuarës në raport me të ndjerin, prandaj, Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka refuzuar për sigurimin edhe të provave tjera materiale nga shteti i Francës, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë.”*
19. Në vazhdim të shqyrtimit të këtij pretendimi, rikujtoj arsyetimin nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML. nr. 310/2020] të 28 prillit 2021, përmes të cilit është refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe e cila arsyeton si në vijim: *“Përkitazi me shkëlqje të ligjit penal siç del nga përmbajtja e kërkesës, mbrojtësja pretendon se në rastin konkret është shkelur ligji penal, ngase sipas mbrojtjes së të dënuarës dhe provave materiale e dënuara ka vepruar në mbrojtje të nevojshme si pasojë e abuzimit seksual të të ndjerit me të miturin dhe keqtrajtimin apo dhunën e përdorur të të ndjerit ndaj të dënuarës natën kritike, e të cilat rrethana flasin për vrasje të kryer në mbrojtje të nevojshme nga neni 179, par. 1 pika 3 lidhur me nenin 12 par. 1 përkatësisht 4 të KPRK-së. Mirëpo, këto pretendime kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Së pari, në këtë çështje juridiko penale nuk rezulton kontestues fakti se raportet bashkëshortore në mes të dënuarës dhe të ndjerit nuk ishin të mira dhe se i ndjeri ka përdorur dhunë ndaj të dënuarës, por përkitazi me momentin kritik nuk ka dëshmitar okular të ngjarjes.[...] sa i përket propozimit të mbrojtëses për ekspertizën psikiatrike për të vërtetuar gjendjen psikike të të dënuarës në momentin e kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar një propozim të tillë dhe në këtë drejtim ka dhënë arsye të qarta të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë. E dënuara fillimisht kishte jetuar me familjen e të dënuarit, pastaj kishin shkuar në Francë dhe atje një kohë kishte jetuar vetëm dhe sipas kërkesës së saj edhe i ndjeri kishte shkuar në Francë për të jetuar me të [...] Pastaj, nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë provë që e argumenton faktin se e dënuara natën kritike kishte pësuar lëndime nga i ndjeri, andaj edhe pretendimet në këtë drejtim janë të pabazuara dhe për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka mbrojtja e mbështet këtë pretendim. Në fakt, rezulton se gjykata ka refuzuar të administroj raportet mjekësore para ngjarjes kritike, por në shkresat e lëndës nuk ka prova që e argumentojnë faktin se e dënuara natën kritike kishte pësuar lëndime nga i ndjeri.*
20. Më tej, në dritën e sa më sipër, vërej se parashtruesja e kërkesës u shpall fajtores pas analizimit të një numri të madh provash të paraqitura nga mbrojtja e saj si dhe nga palët e tjera, dhe nga e gjithë kjo rezulton se parashtruesja e kërkesës kishte mundësinë të paraqiste prova që mund të ndikojnë në lirimin e saj nga fajësia.
21. Më tej, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës se aktgjykimet e shkallëve më të ulëta bazohen në prova që, sipas mendimit të saj, nuk përmbushin standardet e përcaktuara me ligj për t'u konsideruar si provë, rikujtoj arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 133/2020] e cila gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi shtoi se të gjitha provat e marra nga shteti francez janë përpunuar në përputhje me dispozitat ligjore të këtij të fundit, *“që do të thotë se sipas dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim*

*Juridik Ndërkombëtar të Kosovës, të gjitha provat që sigurohen nga Shteti tjetër duhet të jenë të proceduara konform dispozitave të atij shteti, gjë që edhe ka ndodhur në rastin konkret“.*

22. Më tutje, citoj Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ku në ndërlidhje me këtë pretendim shton se “...janë të pabazuar pretendimet se këto prova nuk janë siguruar në mënyrë të ligjshme, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se provat e siguruara nga autoritetet Franceze janë marrë konform dispozitave të kodit të procedurës penale të Francës dhe si të tilla edhe i janë dorëzuar autoriteteve vendore. Në fakt, mbrojtësja vetëm citon dispozitat ligjore të kodit të procedurës penale (neni 209 par. 6 të KPPK-së) por nuk e konkretizon faktin se në çka konsiston kundërligjshmëria e tyre, e përveç kësaj ato nuk janë prova e vetme apo vendimtare për gjetjen e fajësisë siç u tha edhe më lart, ngase e dënuara e ka pranuar faktin se e ka kryer vrasjen por nën pretekstin se ka qenë e sulmuar [...]
23. Në dritën e parimeve të përgjithshme të GJEDNJ-së të përmendura më lart dhe arsytimit të gjykatave të rregullta, në radhë të parë konsideroj se në rastin e parashtrueses së kërkesës, gjykatat e rregullta kanë marrë vendimet e tyre në përputhje me standardet e kërkuara për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe vendimmarrja e tyre nuk është bazuar jo vetëm në një provë, por në disa prova, të cilat Gjykata Themelore i ka cituar në aktgjykimin e saj dhe të cilat më vonë janë konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit edhe nga Gjykata Supreme.
24. Gjithashtu vërej se procedura penale kundër parashtrueses së kërkesës ishte e drejtë në tërësi, pasi gjykatat respektuan të drejtën e mbrojtjes. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se në procedurën pranë gjykatave të rregullta, parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia, përmes përfaqësuesit të saj ligjor, të propozojë prova si dhe t'i kundërshtojë ato, me prova që janë paraqitur gjatë procedurës penale.
25. Prandaj, bazuar në arsyetimin e mësipërm, vërej se parashtruesja e kërkesës nuk arriti të dëshmojë se në rastin e saj gjykatat e rregullta nuk kanë administruar prova në përputhje me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së si dhe parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilat gjithashtu përfshihen në dispozitat përkatëse të procedurës penale, prandaj konsideroj se këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë të pabazuara.

### **(III) Vlerësimi i kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e së drejtës për t'i marrë në pyetje të tërthortë dëshmitarët**

26. Parashtruesja e kërkesës pretendon se ajo nuk e kishte mundësinë të merrte në pyetje dëshmitarin i cili, sipas fjalëve të saj, ndikoi me dëshminë e tij që parashtruesja e kërkesës të shpallej fajtores.
27. Rikujtoj se kriteret e përgjithshme në lidhje me të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij janë elaboruar në detaje në praktikën gjyqësore të Gjykatës në rastin KI14/18, parashtrues *Hysen Kamberi*, Aktgjykim i 15 janarit 2020, paragrafët 47 deri në 76, dhe në të cilin aktgjykimi bazohet në dy rastet e GJEDNJ-së, *AI-Khawaja dhe Tahery kundër Mbreterisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2011 dhe *Schatschaschëili kundër Gjermanisë*, aktgjykim i 15 dhjetorit 2015.
28. Në lidhje me këtë, theksoj se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke pasur parasysh se pranueshmëria e dëshmimeve është në parim çështje që duhet të rregullohet me ligj dhe përmes gjykatave vendore, bazuar në paragrafin 1 dhe pikën d të paragrafit



3 të nenit 6 të KEDNJ-së, ajo shqyrton vetëm nëse procedurat, në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të drejtë. (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 46; shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 101; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 12 shtatorit 2016, paragrafi 57). Këto dispozita, megjithatë ngërthejnë në vetvete prezumimin kundër përdorimit të dëshmime jashtëgjyqësore kundër të akuzuarit në një procedurë penale. E njëjta vlen edhe kur një dëshmi e tillë mund të jetë në favor të mbrojtjes (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 46).

29. Përveç kësaj, bazuar në pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së, para se një i akuzuar të mund të dënohet, të gjitha dëshmitë kundër tij duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë dëgjimore publike me qëllim të dhënies së mundësisë së kundërshtimit të argumenteve. (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 47; shih, rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 101; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 57). Përgjashtimet nga ky parim janë të mundshme, por në asnjë rrethanë, nuk mund të cenojnë të drejtat e mbrojtjes, e të cilat, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësi adekuate dhe reale për të kundërshtuar dhe për të marrë në pyetje dëshmitarin kundër tij, qoftë kur ai dëshmitar e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme të procedurës (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 47; shih, rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Hümmer kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 19 korrikut 2012, paragrafi 38; *Lucà kundër Italisë*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2001, paragrafi 39; *Solakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 57; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 105). GJEDNJ, megjithatë, gjithashtu ka theksuar se përdorimi i deklaratave të marra në fazën e hetimeve policore e gjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me paragrafin 1 dhe pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, me kushtin që të drejtat e mbrojtjes të jenë respektuar. Si rregull i përgjithshëm, i akuzuari dhe mbrojtja e tij duhet të kenë mundësi adekuate për të kundërshtuar dhe pyetur dëshmitarin përkatës, ose kur i njëjti ka bërë deklaratën ose në një fazë të mëvonshme të procedurës gjyqësore. (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 47; shih edhe rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Trampevski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 10 korrikut 2012, paragrafi 44; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 105).
30. GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se duke marrë parasysh vendin që ka e drejta për funksionim të drejtë të sistemit gjyqësor në një shoqëri demokratike, çdo masë që kufizon të drejtat e mbrojtjes duhet të jetë rreptësisht e nevojshme. Nëse një masë më pak kufizuese mund të mjaftojë, atëherë ajo duhet të zbatohet. (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 23 prillit 1997, paragrafi 58). Mundësia e të akuzuarit që të përballet me dëshmitarët në prani të një gjyqtari është një element qenësor i një procesi gjyqësor të drejtë. (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 48; shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Taräu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 shkurtit 2009, paragrafi 74).
31. Prandaj, GJEDNJ-ja theksoi se nëse ndodh ndonjë përjashtim i tillë, atëherë: (i) gjykata përkatëse duhet së pari të shqyrtojë pyetjen paraprake, përkatësisht nëse ka pasur arsye të qëndrueshme për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë, duke pasur parasysh që, si rregull i përgjithshëm, dëshmitarët duhet japin dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e tyre; (ii) kur dëshmitari nuk është marrë në pyetje në asnjë fazë të



mëparshme të procedurës, pranimi i deklaratës së dëshmitarit në vend të dëshmime të drejtpërdrejta në proces gjyqësor duhet të jetë masa e fundit; (iii) pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve në mungesë rezultojnë në një disavantazh potencial për të akuzuarin, i cili, në parim, duhet të ketë mundësi efektive për të kundërshtuar dëshmitë kundër tij. Në veçanti, ai duhet të jetë në gjendje të testoj vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmime të dhëna nga dëshmitarët, duke siguruar marrjen e tyre në pyetje në praninë e tij, qoftë në kohën kur dëshmitari e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës; (iv) sipas “*rregullit të vetëm ose vendimtar*” (sole or decisive rule), nëse dënimi i të akuzuarit bazohet vetëm ose kryesisht në dëshmi të siguruar nga dëshmitarë të cilët i akuzuari nuk ka pasur mundësi t’i marr në pyetje në ndonjë fazë të procedurës, të drejtat e tij të mbrojtjes janë të kufizuara padrejtësisht; (v) megjithatë, duke marrë parasysh që pika d e paragrafit 3 të nenit 6 të iKEDNJ-së duhet të interpretohet në kuptim të rregullsisë së përgjithshme të procedurës - “*rregulli i vetëm ose vendimtar*” nuk duhet të zbatohet në mënyrë jofleksibile; dhe (vi) në veçanti, kur një deklaratë jashtëgjyqësore është dëshmia e “*vetme ose vendimtare*” kundër një të akuzuari, pranimi i saj si dëshmi nuk rezultojnë detyrimisht në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në një rast të tillë megjithatë, procedurat gjyqësore duhet t’i nënshtrohen një kontrolli rigoroz procedural. Për shkak të rreziqeve të pranimi të dëshmime të tilla, gjykata përkatëse duhet të bazoj vendimin e saj në faktorë kundërbalancues, duke përfshirë masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së dëshmisë përkatëse. Kjo do të mundësonte që një dënim të bazohet në dëshmi të tilla vetëm nëse ato janë mjaftueshëm të besueshme (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 51).

32. Ndërsa, përkitazi me testin e zhvilluar në rastin *Al-Khawaja and Tahery*, për të vlerësuar përputhshmërinë me garancitë e mishëruara në pikën d të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është e nevojshme të shqyrtohen tri çështje themelore, në çdo rast kur deklaratat e dëshmitarëve që kanë munguar në shqyrtim gjyqësor janë pranuar si dëshmi në gjykatë. Gjykata duhet të shqyrtoj nëse (i) ka pasur arsye të qëndrueshme për mos-pjesëmarrjen e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor dhe për pasojë, pranimin e dëshmime jashtëgjyqësore të dëshmitarit në mungesë si dëshmi në gjykatë; (ii) a ishte dëshmia e dëshmitarit në mungesë baza e “*vetme ose vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit; dhe (iii) a ka faktor të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë garancione të forta procedurale, në mënyrë që të kompensohet disavantazhi i mbrojtjes si rezultat i pranimi të dëshmisë jashtëgjyqësore dhe për të siguruar që gjykimi, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë. (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 52; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 107; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 58). Gjykata në vijim do t’i shtjelloj më detajisht të tri çështjet e identifikuar.

### ***Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret***

33. Duke marrë parasysh parimet e lartpërmendura në lidhje me të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje të tërthortë dëshmitarët kundër tij, unë do të vlerësoj më tej zbatimin e parimeve të lartpërmendura në këtë rast konkret, me qëllim që të konstatoj nëse pamundësia të merren në pyetje dëshmitarët në rastin në shqyrtimin gjyqësor, deklaratat e të cilit lexohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka rezultuar me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.
34. Së pari, vërej se parashtruesja e kërkesës i paraqiti këto pretendime edhe në gjykatat e shkallës më të ulët.
35. Së pari, i referohem aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ku, siç u tha më lart, fajësia e parashtrueses së kërkesës u vërtetua pas një sasive të madhe provash, duke përfshirë,

ndër të tjera, deklaratat e dëshmitarëve H.S., A.S. si dhe E.H. dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe deklaratat e dëshmitarëve CH.J. dhe A.D. të cilat janë lexuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

36. Në lidhje me këtë, rikujtoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore [PKR. nr. 37/19], ku ndër të tjera provat e përmendura që janë paraqitur në lidhje me këtë rast dhe të cilat janë dëgjimi i dëshmitarëve H.S, A.S dhe E.H dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe leximi i deklaratave/dëshmitarëve Ch.J, A.D dhe H.S të dhëna para autoriteteve franceze dhe të shqyrtuara në kuptim të provave materiale, më pas një numër i madh procesverbalesh, një raport autopsie mjeko-ligjore, një certifikatë vdekjeje e lëshuar më 29 shtator 2018.
37. Më tej, dhe lidhur me këtë pretendim, rikujton aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, i cili vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në këtë pikë, duke theksuar se: *“ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe ekspertizën mjeko-ligjore, pastaj, deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të cilat edhe ashtu nuk ndryshojnë në kuptim të vërtetimit të fakteve themelore, sidomos përkitazi me vërtetimin e fakteve dhe rrethanave se si erdhi deri tek privimi nga jeta i tani të ndjerit A.S.fakte dhe rrethana këto që nuk i kundërshton as vet e akuzuara, por që pretendon se në momentin kritik ka qenë e sulmuar nga tani i ndjeri, për arsye, dhe në lidhje me këtë, gjykata e shkallës së parë.”*
38. Gjithashtu i referohem edhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ku në arsyetimin e këtij të fundit, duke u mbështetur në nenin 262 të KPPK-së, thekson se: *“Në këtë çështje juridiko penale, duke pasur parasysh faktin se vrasja është kryer në Francë, dhe pas kryerjes së vrasjes e dënuara ka ardhur në Kosovë ku edhe është arrestuar është evidente se një mori provash janë siguruar nga autoritetet e organeve kompetente të Francës, në mesin e tyre edhe dëshmitë e dëshmitarëve J.C., A. D. dhe H. S. të cekura në kërkesa dhe këto dëshmi e dënuara nuk ka mundur që në shqyrtimin gjyqësor t'i kundërshtoj përmes marrjes në pyetje, por nga ky fakt nuk mund të pretendohet se ato janë të papranueshme siç pretendohet në kërkesës, ngase me dispozitën e nenit 262 parashihet se këto prova nuk e përcaktojnë fajsinë e që në rastin konkret nuk e kanë përcaktuar ngase bëhet fjalë për dëshmitë e dëshmitarëve që kanë treguar për raportet e tyre me të ndjerin dhe të dënuaren. Pastaj nuk janë prova kryesore për ta vërtetuar faktin më të rëndësishëm nëse natën kritike kishte fjalosje dhe konflikt fizik në mes të dënuarës dhe të ndjerit ashtu siç pretendon mbrojtësja, ngase nuk janë dëshmitarë okular të ngjarjes (në këtë çështje nuk ka dëshmitar okular të ngjarjes për të treguar se si është zhvilluar ngjarja kritike) dhe as që gjykata i ka vlerësuar si prova të tilla.”*
39. Duke pasur parasysh arsyetimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme, lidhur me pretendimin e parashtrueses së kërkesës se nuk ishte në gjendje të kundërshtonte dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna para autoriteteve franceze, gjë që sipas saj ndikoi në konstatimin e fajit, vërej se dëshmitë të dhëna dhe të cilat u lexuan në seancën gjyqësore dhe të cilat nuk mund të kontestoheshin nga parashtruesja e kërkesës, në radhë të parë nuk ishin vendimtare për shpalljen e parashtrueses së kërkesës fajtoresh, sepse aktgjykimi i Gjykatës Themelore bazohej kryesisht në pranimin e fajësisë nga ana e parashtrueses së kërkesës, dhe më pas edhe për një sasi të konsiderueshme të provave materiale si dhe në provat e tjera të dhëna në shqyrtimin kryesor të cilat parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi t'i kontestojë.
40. Në dritën e të gjitha të lartpërmendurave, pas analizimit të shkresave të lëndës, si dhe arsyetimeve të vendimeve të gjykatave të rregullta të shkallëve më të ulëta, konsideroj se dëshmitë e dëshmitarëve Ch.J, A.D dhe H.S, të cilat vetëm janë lexuar gjatë seancës gjyqësore dhe që nuk kanë mundur të kontestohen nga ana e parashtrueses së kërkesës,

nuk janë prova vendimtare për të vërtetuar faktin që është më i rëndësishmi në lidhje me fajësinë e saj, sepse në rastin konkret bëhet fjalë për dëshmitë e dëshmitarëve që kanë folur në lidhje me marrëdhënien ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe të ndjerit, duke shpjeguar se këta dëshmitarë nuk ishin dëshmitarë okularë të ngjarjes.

41. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata vlerëson se fakti që dëshmitë e dëshmitarëve Ch.J, A.D dhe H.S vetëm janë lexuar në seancën gjyqësore nuk ka ndikuar që procedura gjyqësore kundër parashtrueses së kërkesës të konsiderohet të ketë qenë e padrejtë tërësinë e saj, siç parashikohet në të drejtën për një gjykim të drejtë, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
42. Prandaj, edhe ky pretendim i parashtrueses së kërkesës është i pabazuar.

**(IV) Vlerësimi i kushtetutshmërisë në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtave gjatë marrjes së dëshmisë së [X.X.], i cili në atë kohë ishte i mitur, i njëjti është marrë në pyetje vetëm në prani të punëtorit social dhe jo psikologut.**

43. Në lidhje me këtë, rikujtoj edhe një herë pretendimin e parashtrueses së kërkesës, e cila në kërkesën e saj theksoi se gjatë marrjes në pyetje, në cilësinë e dëshmitarit okular X.X., i mitur, ky i fundit ka dhënë dëshminë e tij vetëm para një punëtori social dhe jo para një psikologu.
44. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e ka ngritur këtë pretendim edhe para të gjitha instancave të tjera gjyqësore.
45. Në lidhje me këtë, rikujtoj Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i cili në arsyetimin e tij lidhur me këtë pretendim thekson se: *“nuk është shkelur as dispozita e nenit 130, paragrafi 5 të KPPK. Në fakt, sipas kësaj dispozite me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është i dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. Kur është e nevojshme ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë, ose pedagogut për fëmijë, ose ekspertit tjetër që është profesional. Pra, nga kjo dispozitë del se marrja në pyetje nëpërmjet psikologut nuk është detyrim i gjykatës por në rast se gjykata e sheh të nevojshme, pra është në diskrecion të gjykatës të vlerësoj se duhet të dëgjohet personi që nuk ka mbushur 18 vjet nëpërmjet psikologut apo personave të tjerë profesional. Në rastin konkret, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme, por X.X. është marrë në pyetje në prezencë të përfaqësuesit të punëtorit social dhe ka vepruar me kujdes të posaçëm sepse siç del nga shkresat e lëndës mbrojtësi të gjitha pyetjet ai ka parashtruar nëpërmjet të dënuarës”.*
46. Më tej rikujtoj se edhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, me rastin e shqyrtimit të këtij pretendimi, janë në të njëjtën linjë me arsyetimin e Gjykatës Supreme, si dhe në arsyetimin e Gjykata Themelore lidhur me këtë çështje, thekson se Gjykata Themelore pjesërisht i falë besimin dëshmisë së dëshmitarit X.X. sepse nga dëshmia e tij vërehet *“se është e qartë se këto deklarata janë bërë nën ndikimin e tashmë të akuzuarës Suzana”.*
47. Për të shqyrtuar këto pretendime, në radhë të parë do t'i referohem paragrafit 5 të nenit 130 të KPPK-së, i cili përcakton se:

*“Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, sidomos kur ai është dëmtuar me veprën penale veprohet me kujdes që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij mendore. Kur është e nevojshme, ai pyetet*

*me ndihmën e psikologut për fëmijë ose pedagogut për fëmijë apo ekspertit tjetër profesional ”*

48. Duke pasur parasysh sa më sipër, konsideroj se vetë përmbajtja e paragrafit 5 të nenit 130 të KPPK-së i lejon gjykatave të rregullta të drejtën diskrecionale në kuptimin që sa herë që gjykatat e konsiderojnë të nevojshme, i mituri pyetet ose me ndihmën e psikologut ose një pedagog ose një ekspert profesionist. Në bazë të paragrafit 5 të nenit 130, parashikohet që gjatë marrjes në pyetje të të miturve duhet të plotësohen në mënyrë alternative kushtet e përcaktuara si *“me ndihmën e psikologut, pedagogut ose ekspertit profesional”*.
49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se marrja në pyetje e X.X.-së në cilësinë e dëshmitarit është bërë në prani të punonjësit social, prandaj kushti i tretë i paragrafit 5 të nenit 130 të KPPK-së është plotësuar.
50. Në dritën e asaj që u tha më lart, dhe në lidhje me këtë pretendim, Gjykata arrin në përfundimin se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Pml. nr. 310/220], është i qartë dhe se trajton të gjitha pretendimet thelbësore që janë paraqitur nga parashtruesja e kërkesës në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si dhe në të gjitha gjykatat e shkallëve më të ulëta. Nuk ka asnjë argument thelbësor që Gjykata Supreme apo gjykatat më të ulëta ta kenë lënë mënjanë si të paarsyetuar, siç pretendohet nga parashtruesja e kërkesës. Prandaj, konsideroj se kjo sjellje e gjykatave të rregullta nuk ka ndikuar në faktin që procedura gjyqësore ndaj parashtrueses së kërkesës të konsiderohet të ketë qenë e padrejtë në tërësi, siç parashikohet në të drejtën për një gjykim të drejtë, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
51. 5Prandaj, edhe ky pretendim i parashtrueses së kërkesës është i pabazuar.

**(V) Mendim për detyrimin për vendosjen e masës së përkohshme sipas detyrës zyrtare (ex officio)**

52. Konsideroj se kur Gjykata vendosi TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM aktgjykimin [Pml. nr. 310/220] të 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; aktgjykimin [PAKR. nr. 328/19] të 20 gushtit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të 17 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është dashur të vendos masën e përkohshme sipas detyrës zyrtare.
53. Rikujtoj se neni 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton se *“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”*.
54. Duke pasur parasysh se gjykata vendosi të anulojë të gjitha aktgjykimet në bazë të të cilave parashtruesja e kërkesës ishte duke vuajtur dënimin me burg, konsideroj se gjykata ishte e detyruar që sipas detyrës zyrtare të vendoste një masë të përkohshme që do ta linte parashtruesen e kërkesës në paraburgim deri në vendimin e parë të gjykatave të rregullta.
55. Konsideroj se kur Gjykata vendosi TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM aktgjykimin [Pml. nr. 310/220] të 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; aktgjykimin [PAKR. nr. 328/19] të 20 gushtit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të 17 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk ka më asnjë bazë ligjore që parashtruesja e kërkesës të qëndrojë në burg apo në paraburgim, sepse

parashtruesja e kërkesës ishte duke vuajtur dënimin me burg në bazë të aktgjykimeve të anuluar.


56. Duke marrë parasysh se fajësia e parashtrueses së kërkesës, e cila vetë e pranoi kryerjen e veprës penale, me të cilën ajo ngarkohet, moskaktimi i masës së përkohshme që do ta mbante parashtruesen e kërkesës në paraburgim deri në marrjen e vendimit të parë të gjykatës së rregullt, për mendimin tim, ishte detyrim i kësaj Gjykate për të shmangur mundësinë e lirimit të parashtrueses së kërkesës dhe pengimin të përsëritjes së procedurës së urdhëruar nga Gjykata Kushtetuese përmes këtij aktgjykimi.

#### **(VI) Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtrueses së kërkesës**

1. Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh shqyrtimet e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës në kërkesën e saj:
  - I. PAJTOHEM me konkluzionin e Gjykatës që TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
  - II. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur të KONSTATOJË se aktgjykimi [Pml. nr. 310/220] i 28 prillit 2021 i Gjykatës Supreme të Kosovës; aktgjykimi [PAKR. nr. 328/19] i 20 gushtit 2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimi [PKR. nr. 37/2019] i 17 dhjetorit 2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk kanë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
  - III. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur TË LË NË FUQI JURIDIKE aktgjykimin [Pml. nr. 310/220] të 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës; aktgjykimin [PAKR. nr. 328/19] të 20 gushtit 2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe aktgjykimin [PKR. nr. 37/2019] të 17 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
  - IV. PAJTOHEM me konkluzionin e Gjykatës që TA REFUZOJË kërkesën e parashtrueses për vendosjen e masës së përkohshme;
  - V. KONSIDEROJ SE Gjykata, sipas detyrës zyrtare, në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, është dashur të vendosë masë të përkohshme me të cilën do të caktonte paraburgimin e parashtrueses deri në marrjen e vendimit të parë të Gjykatës Themelore për masën e sigurimit të pranisë së të pandehurës në procedurë.

#### **Mendimi mospajtues është paraqitur nga gjyqtari;**

Radomir Laban, gjyqtar



Më 02 gusht 2023 në Prishtinë